



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 19553/Prot

Shkodër, më 17.11.2021

Lënda: Dhënie informacioni

KUVENDIT ✓

**Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.4, Tiranë
Tiranë**

Në vijim të shkresës suaj nr.2681 prot, datë 05.11.2021 “Shkresë përcjellëse”, administruar me nr.19553 prot, datë 08.11.2021, po ju dërgojmë si më poshtë të dhënat e kërkuara nga ana juaj,

Struktura organizative e Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shoqërive aksionere është e ndërtuar si më poshtë:

1. **Administrata**
2. **Gjendja Civile**
3. **Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)**
4. **Sportklub "Vllaznia"**
5. **Teatri “Migjeni”**
6. **Dega Ekonomike e Kulturës**
7. **Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve**
8. **Drejtoria Ekonomike e Arsimit**
9. **Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi**
10. **Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore**

SHOQËRITË AKSIONERE

1. Ujësjiellës kanalizime Shkodër
2. Trajtimi i Studentëve Shkodër
3. Klubi i Futbollit “Vllaznia”

Referuar kërkesës suaj në lidhje me pikën 1 dhe 2:

1. Sa ka qenë numri i të punësuarve pranë Bashkisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë dhe shoqëritë në pronësi të saj për periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas secilit muaj të kësaj periudhe:
2. Sa është numri i të punësuarve pranë Bashkisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë dhe shoqëritë në pronësi të saj për periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas secilit muaj të kësaj periudhe:

Nr. rendor	Periudha	Bashkia	Gjendja Civile	QKB	Sport klub "Vllaznia"	Teatri 'Migjeni'	Dega Ekonomike Kulturës	Drejtoria Çerdheve dhe Kopshteve	Drejtoria Ekonomike Arsimi	Drejtoria Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore	Nr. total i të punësuarve
1	Janar 2020	353	18	2	57	40	29	236	187	33	32	987
2	Shkurt 2020	348	19	2	56	40	29	236	226	32	32	1020
3	Mars 2020	344	19	2	54	40	29	236	224	34	32	1014
4	Prill 2020	347	20	2	54	40	29	236	223	35	32	1018
5	Maj 2020	347	20	2	54	40	30	236	221	34	32	1016
6	Qershor 2020	350	20	2	53	40	30	235	220	33	40	1023
7	Korrik 2020	351	20	2	53	40	29	239	219	33	42	1028
8	Gusht 2020	350	20	2	52	40	29	237	220	35	42	1027
9	Shtator 2020	352	20	2	50	39	29	239	232	35	43	1041
10	Tetor 2020	347	20	2	54	41	30	239	234	35	43	1045
11	Nentor 2020	345	20	2	54	40	30	239	232	35	43	1040
12	Dhjetor 2020	347	20	2	55	40	30	239	229	35	33	1030
13	Janar 2021	348	20	2	55	41	30	239	226	36	33	1030
14	Shkurt 2021	346	20	2	54	40	30	239	235	36	33	1035
15	Mars 2021	337	20	2	52	40	30	239	230	36	33	1019
16	Prill 2021	339	20	2	51	40	28	239	230	35	33	1017

SHOQËRITË AKSIONERE

Nr.rendor	Periudha	Ujësjetllës kanalizime Shkodër	Trajtimi i Studentëve Shkodër	Klubi Futbollit Vllaznia	Nr total i të punësuarve
1	Janar 2020	325	22	72	419
2	Shkurt 2020	323	22	70	415
3	Mars 2020	321	22	69	412
4	Prill 2020	320	22	68	410
5	Maj 2020	319	22	68	409
6	Qershor 2020	320	22	68	410
7	Korrik 2020	318	22	52	392
8	Gusht 2020	317	22	59	398
9	Shtator 2020	311	22	63	396
10	Tetor 2020	307	22	76	405
11	Nentor 2020	311	22	73	406
12	Dhjetor 2020	310	22	79	411
13	Janar 2021	309	22	77	408
14	Shkurt 2021	309	22	76	407
15	Mars 2021	312	22	76	410
16	Prill 2021	312	22	75	409

3. Në lidhje me pikën 3, 4 dhe 5, rritje të pagave, shtesa apo shpërblime për këtë periudhë nuk kemi pasur përveç rritjes së pagës minimale në zbatim të Vendimit Nr.1025, datë 16.12.2020 "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi", i cili ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2021, ku paga bazë mujore nga 26.000 lekë është bërë 30.000 lekë.

Në Bashkinë Shkodër dhe institucionet në varësi të saj kanë përfituar në total 159 punonjës në zbatim të këtij vendimi.

Në Shoqëritë Aksionere kanë përfituar nga ky vendim 10 punonjës tek Trajtimi i Studentëve, 12 punonjës tek Klubi i Futbollit "Vllaznia" dhe 147 punonjës tek Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, pra në total 169 punonjës.

Në total nga VKM-ja Nr.1025, date 16.12.2020 "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi" në Bashkinë Shkodër, institucionet në varësi të saj dhe shoqëritë aksionere në pronësi kanë përfituar **328 punonjës**.

Gjithashtu, në zbatim të VKM-së nr.175 datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar" i ndryshuar, kanë përfituar 128 punonjës konkretisht edukatorë dhe drejtorë të kopshteve, pranë Drejtorisë së Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë

Shkodër si edhe 5 punonjës të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër, në total **133 punonjës**.

4. Në lidhje me pikën 6, Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike për periudhën Dhjetor 2020 deri Prill 2021 kanë qenë si më poshtë:

Viti 2020:

Në muajin Janar 1864 familje, nga të cilat: 1673 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 191 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt 1856 familje, nga të cilat: 1663 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 193 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars 1824 familje, nga të cilat: 1639 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 185 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill 1916 familje, nga të cilat: 1724 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 192 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj 2048 familje, nga të cilat: 1841 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor 2131 familje, nga të cilat: 1924 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik 2052 familje, nga të cilat: 1853 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 199 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht 2022 familje, nga të cilat: 1826 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 196 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator 2020 familje, nga të cilat: 1813 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor 1980 familje, nga të cilat: 1775 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nëntor 1984 familje, nga të cilat: 1779 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor 1970 familje, nga të cilat: 1765 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Viti 2021:

Në muajin Janar 2014 familje, nga të cilat: 1810 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 204 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt 2064 familje, nga të cilat: 1855 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars 2107 familje, nga të cilat: 1898 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill 2122 familje, nga të cilat: 1913 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në zbatim të VKM-së nr.85, datë 10.02.2021 "Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", masa e ndihmës ekonomike është dyfishuar për një periudhë 6-mujore (Janar - Qershor).

5. Në lidhje me pikën 7 – A kanë qënë të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës së përfitimit të saj?

Në zbatim të ligjit të Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë",

VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", Kreu II, pika 4 citon:

Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjëndjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Sa më sipër, konfirmojmë që të gjithë anëtarët madhor të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë paraqitur çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror

6. Në lidhje me pikën 8 dhe 9 – Sa është numri i lejeve të ndërtimit që janë dhënë për periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021 të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhë dhe për secilën njësi vendore?

Numri i lejeve është si mëposhtë:

Muaji	Nr.lejeve	Numri i hapësirës në m ²
Janar 2020	3	316
Shkurt 2020	0	0
Mars	5	1013.4
Prill	6	612
Maj 2020	2	383

Qershor 2020	5	1051
Korrik 2020	3	434.3
Gusht 2020	1	546
Shtator 2020	1	35
Tetor 2020	1	149
Nëntor 2020	4	1846.5
Dhjetor 2020	6	1513.48
Janar 2021	4	593.4
Shkurt 2021	3	259.6
Mars 2021	4	721.8
Prill 2021	4	10988.9

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Voltana Ademi

